

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot në datë 18.04.2023, lidhet kjo kontratë dhurimi kuotash ndërmjet palëve të mëposhtme:

PALA DHURUESE : XHOVAN GJINI, e biri e Frrok dhe Kristina, shtetas Shqiptar, lindur me 10 Dhjetor 1992, ne Vau Dejes, banues ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit me numer personal J21210062M, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar, ortak i shoqërisë ortak i shoqërisë "AMAR 17" sh.p.k (Kodi NUIS M21503014Q), që merr pjesë në shoqëri me 100 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë.

PALA PRANUESE E DHURIMIT : ALBA HALILI, e bija e Sokol dhe Rudina, shtetas Shqiptar, lindur me 12 Korrik 1992, ne Shkoder, banues ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit me numer personal J25712049S, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

OBJEKTI I KONTRATËS: Dhurimin e 1 kuote e barazvlefshme me 100 % të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë "AMAR 17" sh.p.k (Kodi NUIS M21503014Q)

BAZA LIGJORE: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (neni 705 e vijues), Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Statuti i shoqërisë "AMAR 17" shpk

Nga deklaratimet e palëve të mësipërme dhe nga dokumentet e paraqitura rrjedh se:

- a) **Z.Xhovan Gjini** është ortak i vetem 100 % të shoqërisë "AMAR 17" sh.p.k, me seli TIRANE Njesia Bashkiake nr.11, Rruga Don Bosko, Zona Kadastrale 8310, Kompleksi Nord Konstruksion shpk e regjistruar pranë QKB (*Qendrës Kombëtare të Biznesit*), me kapital të shoqërisë prej 2,000,000 (dy milion) lekë. Në këtë kapital ai zotëron 1 (një) pjesë dhe 100 (*njeqind*) % të kapitalit të shoqërisë;
- b) **Z. Xhovan Gjini** deklaron se 1 kuotë të tij në shoqëri (*e që përbëjnë një pjesë dhe 100 % të kapitalit të shoqërisë*) ai ka ndër mend t'ia dhuroje bashkeshortes se tij;
- c) **Znj Alba Halili** kane shprehur dëshirën e saj dhe pranon dhurimin e kuotave nga bashkeshorti i saj;
- d) Ky veprim i shitblerjes së kuotave është miratuar nga asambleja e ortakëve të shoqërisë me vendimin përkatës.

DEKLARIME DHE GARANCI : Pala shitesë deklaron dhe garanton pranuesen e dhurimit se:

- Dhuruesi deklaron dhe garanton pranuesin e dhurimit se pjesët (kuotat) e kalipitalit të shoqërisë objekt i kësaj kontrate janë të transferueshme dhe të lira nga cdo barrë hipoteke, apo cdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- Ne cilesine e ortakut te shoqërisë "AMAR 17" shpk nuk ka shitur, dhuruar, premtuar për shitje, dhene si garanci apo ne cdo lloj forme tjetër te kete disponuar mbi pjese te kuotes se kapitalit apo aseteve te shoqërisë.

- Ne cilesine e ortakut te shoqerise garanton se blesin se shoqeria., nuk ka asnje borxh ndaj insitucione shteterore si taksa, tatime, apo pale te treta private perfshire Bankat qe mund te coje ne uljen e vleres se kuotes se dhuruar .

- Dhuruese deklarone se me nenshkrimin e kesaj marreveshjeje nuk ka asnje pretendim te tanishem apo te mevonshem te asnje lloji per dhurimin te kuotes duke e konsideruar ate te drejte dhe te sakte.

Pala pranuese e dhurimit deklarone dhe garanton dhuruesin se:

- Nuk ka asnje pengese per lidhjen e kesaj kontrate dhurimi .

CMIMI : Sot ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, të dy palët deklarojnë se z.Xhovan Gjini dhuron dhe znj. Alba Halili pranon dhurimin nga bashkeshort sasj z.Xhovan Gjini të 1 kuotë e barazvlefshme me 100 % të kapitalit në shoqëri e që deri tani i zotëronte z. Xhovan Gjini .

Znj.Alba Halili deklarone se eshte njohur me aktet e shoqërisë dhe me gjendjen ekonomike e financiare të saj dhe deklarone se si ortak te shoqërisë përgjigjet sipas ligjit për të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve lidhur me këtë kalim pronësie, përfshirë dhe detyrimet e mëparshme.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhurimi , Pala Dhuruese Xhovan Gjini e humbet 100 % mbi ato kuota që shiti në kapitalin e shoqërisë “AMAR 17 ” sh.p.k. dhe zotërues i 100 % të tyre bëhet znj Alba Halili me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ky kalim pronësie.

Kuotat dhurohen e zotërohen nga pranuesi i dhurimit që nga data e sotme.

Pas këtij akti shitblerje kuotash, shoqëria e lartpërmendur ka 1 (nje) ortak dhe pikërisht:

1. Znj. Alba Halili , që në kapitalin e shoqërisë zotëron 1 (një) pjesë dhe 100 (njqind) % të kapitalit të shoqërisë me vlere 2,000,000 (dy milion) Lek

ZGJIDHJA E MOSMARVESHJEVE :Palët bien dakord që cdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi dhe ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes palëve. Në rast se bisedimet nuk japin rezultat atëherë konflikti do të zgjidhet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, Shqipëri.


HYRJA NE FUQI :Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Kontrata përpilohet në 2 kopje të njëjta në gjuhën shqipe me vleret te njejte ligjore dhe pasi lexohet nga palet dhe pasi u gjendet ne përputhje te plote me vullnetin e paleve kontraktuese nënshkruhet rregullisht prej tyre personalisht sipas ligjit.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

Xhovan Gjini

Xhovan Gjini


PALA PRANUESE E DHURIMIT

Alba Halili

Alba Halili
